

FJALA E DEPUTETES MIRELA PITUSHI

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

Përshëndetje, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë, Këto ditë të gjithë kemi qenë dëshmitarë të ngjarjeve tronditëse të dhunës dhe përdhunimit ndaj të miturve. Të gjithë jemi shokuar nga veprimet, për të cilat nuk mund të gjenden fjalë për t'i përshkruar. Qytetarët e Fierit ende edhe sot ndihen njësoj të tronditur si familja e Mateos dhe zemërimi është i ligjshëm. Thuhet se drejtësia do të thotë fjalën e saj dhe rasti i Mateos do të mbyllet në arkivat e gjykatës, ndërkohë që është fakt se kjo dukuri nuk po mbaron. Raste të tilla të reja shënohen në ngjarjet e ditës. Çështja dhe pyetja që shtrohet është: çfarë duhet të ndryshojmë që, në mos të zhduket, këto raste të jenë sporadike? A ka një rrugëzgjidhje? Sigurisht që për çdo problem ka edhe një rrugëdalje. Mendoj dhe besoj se rritja e bashkëpunimit me komunitetin nga ana e Policisë së Shtetit duhet të jetë në nivele akoma edhe më të larta. Këtë raport nuk duhet ta shohim vetëm në kuadër të fillimit dhe mbarimit të disa projekteve të policimit në komunitet. Uniformat blu duhet të jenë më të lidhura me banorët e çdo lagjeje dhe rrugice, ata duhet të marrin informacione rreth kontingjentëve dhe të mos bëjnë xhiro me makinë. Ulja në kafe e shefit të zonës dhe biseda me banorët nuk është e jashtëligjshme, por është një shteg dhe mundësi për të marrë një informacion rreth problematikës së zonës.

Ndaj, i mbetem idesë për rritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e nivelit më të lartë në lidhje policinë dhe komunitetin. Në këtë sallë do të sjell edhe një shqetësim tjetër tepër problematik jo vetëm për bashkëqytetarët e mi të Fierit, por edhe më gjerë. Bëhet fjalë për ndotjen e pandalshme të ujërave të lumit Gjanica, i cili me ngjyrën dhe erën e tij të rëndë bën që rreziku për shëndetin e popullit të jetë përherë prezent. Të gjithë jemi gëzuar për investimet e admirueshme që bëhen në shtratin e lumit Gjanica, që kalon mes për mes qytetit të Fierit dhe infrastrukturën moderne në të dyja anët e tij, me mjedise çlodhëse, që nuk kemi fatin e mirë t'i gëzojmë sa dhe si duhet, sepse, nëse provojmë të ulemi buzë lumit, duhet të vendosim dopio maskë, jo nga COVID-i, po nga era mbytëse që vjen prej shtratit të tij. Ujërat e lumit të Gjanicës në raste të rralla, për të mos thënë fare, nuk kanë qetësinë e tyre. Ndotja e ujërave nga kompanitë e naftës, që operojnë në pjesën e sipërme të shtratit të Gjanicës, derdhjet pa kriter, mungesa e gropave të depozitimit të ujërave të ndotura nga këto kompani dhe lëshimi drejt e në lumë, tashmë, jo vetëm që konstatohet, por kërkohet një ndërhyrje e fuqishme dhe parandaluese. Nuk mund të rrija dot pa i shprehur këto dy shqetësime të qytetit të Fierit dhe banorëve të tij. Faleminderit!